



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:022620

Datë: 04.11.2025

Numri i dokumentit: 08005738

KA.nr. 1107/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Gent Bekeri, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Baki Ing” Sh.p.k, me numër të biznesit 810116211 me seli në Podujevë, kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, 2. Komuna e Podujevës, për shkak të heshtjes administrative, jashtë seance me datë 04.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Baki Ing” Sh.p.k, për shkak të heshtjes administrative, kundër të paditurit paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit, 2. Komuna e Podujevës.
- II. OBLIGOHET i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, të vendos lidhur me Ankesën e datës 01.11.2021 të paraqitur nga paditësi “Baki Ing” Sh.p.k dhe vendimin t’ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Baki Ing” Sh.p.k, ka parashtruar padi ndaj të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Komuna e Podujevës, me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative. Në padi ka elaboruar kronologjinë e rastit duke theksuar se AK Komuna e Podujevës ka shpallur njoftimin mbi vendimin më datë 11.08.2021, ndërsa paditësi i pa kënaqur me këtë vendim ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim pran KA-së Komuna e Podujevës. Më datë 19.08.2021 AK Komuna e Podujevës e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar, prandaj paditësi ka parashtruar

ankesë pran OSHP-së. Më datë 13.09.2021 OSHP-ja ka lëshuar raportin e ekspertizës nga eksperti shqyrtues i prokurimit dhe pasi që është pajtuar me ekspertizën AK çështjen e kthen në rivlerësim dhe rivendosje, duke kërkuar sqarime shtese. Më datë 11.10.2021 AK pas procesit të rivlerësimit, ka publikuar njoftimin mbi vendimin ndërsa paditësi më datë 18.10.2021 i pa kënaqur me këtë vendim ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim. Më datë 19.08.2021 AK Komuna e Podujevës ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim ndërsa paditësi i pa kënaqur me këtë vendim ka parashtruar ankesë pran OSHP-së më datë 01.11.2021. Ka theksuar se më datë 15.11.2021 përmes emailit ka pranuar Raportin e Ekspertizës nga Eksperti shqyrtues ndërsa më datë 19.11.2021 brenda afatit ligjor paditësi ka bërë kundërshtimin e ekspertizës. AK më datë 26.11.2021 ka publikuar Njoftimin për dhënien e kontratës si dhe më datë 02.12.2021 ka publikuar njoftimin për Nënshkrimin e kontratës, duke vepruar në kundërshtim me nenin 112 par. 1 të LPP-së ku specifikohet se *“Përveç nëse paneli shqyrtues nxjerr një vendim tjetër me shkrim dhe përderisa të nxjerr këtë vendim, dorëzimi i një ankese e obligon AK-në që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë”*. Ka theksuar se AK në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë afatet e shqyrtimit të ankesës përkatësisht nga dorëzimi i ankesës e deri në ditën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës që ishte bërë më datë 26.11.2021 ishte dita e 26 nga dorëzimi i ankesës, andaj nuk ka respektuar afatin ligjor për shqyrtimin e ankesës dhe në mënyrë të kundërligjshme ka nënshkruar kontratën me OE të pa përgjegjshëm. Më datë 28.12.2021 me kërkesë të përsëritur paditësi ka kërkuar nga OSHP-ja që të shqyrtoj ankesën e datës 01.11.2021 dhe më datë 29.12.2021 është dorëzuar në OSHP kërkesa për shtyrjen e implementimit të kontratës, ndërsa OSHP-ja më datë 06.01.2022 ka njoftuar se bordit i ka kaluar mandati dhe nuk mund të ndërmerret asnjë veprim pa u zgjedhur bordi. Sipas tij OSHP-ja nuk ka shqyrtuar ankesën përmes së cilës ka prezantuar dëshmi duke kërkuar anulimin e vendimit të AK-së Komuna e Podujevës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

E paditura e parë OSHP me datë 14.03.2022, ka parashtruar përgjigje në padi, në të cilën ka theksuar se OE tani paditësi “Baki ING” Sh.p.k, ka kërkuar nga OSHP-ja që të lëshoj një vendim përfundimtar lidhur me çështjen, më saktësisht duke theksuar se AK nuk ka pasur ët drejtë të nxjerr një kontratë, ku sipas paditësi OSHP është duke heshtur, këtë duke e bazuar në dispozitën e nenit 112 par. 1 të LPP-së. Ka shtuar se nga data 31.03.2021 Bordi i OSHP-së i ka skaduar mandati dhe Qeveria akoma nuk e ka emëruar bordin e ri, derisa nuk ka bord OSHP-ja nuk ka si të nxjerr asnjë vendim dhe me asnjë dispozitë ligjore nuk mund të obligoj asnjë autoritet kontraktues që të ndërmerr kurrfarë vendimi. Është më së paku në dorën e OSHP-së që të obligoj

Autoritetit Kontraktuese në kësi lloj rastesh. AK Komuna e Podujevës i ka ndërmarr veprimet ashtu siç ka menduar se është më mirë, ndërsa OSHP-ja nuk ka komision rregullativ që ta kontrolloj andaj çdo padi ndaj OSHP-së është e pa bazuar. Gjykatë i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

E paditura e dytë, Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka theksuar përmes përgjigjes në padi të parashtruar më datë 21.03.2022 ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Sa i përket pretendimeve të paditësit se njoftimi për nënshkrimin e kontratës është publikuar në platformën e prokurimit a iu bashkangjitur kontrata, është i pa bazuar nga shkak se nga dokumenti i Eëb faqes së Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik shihet se janë publikuar të gjitha njoftimet e shihet se është publikuar edhe draft kontrata. Lidhur me pretendimin e paditësi se është dashur të pritët që paneli shqyrtues i OSHP-së të merr vendim dhe se parashtrimi i ankesës e obligon AK-në që automatikisht të pezulloj Aktivitetin e Prokurimit, komuna e Podujevës me anë të kërkesës së datës 15.03.2022, ka kërkuar sqarim nga zyrtari përgjegjës i prokurimit se pasi që OSHP-ja nuk ka pasur dhe aktualisht nuk ka bord, se si të veprohet nga AK. Përgjigja e OSHP-së ka qenë se të gjitha Autoritetet Kontraktuese në mungesë të Bordit të OSHP-së për shqyrtimin e ankesave kanë vazhduar me nënshkrimet e kontratave, të bazuara në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues profesional të OSHP-së. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Paditësi i pa kënaqur me heshtjen e të paditurit, ka ushtruar padi në gjykatë duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ashtu që të obligohet i padituri të nxjerrë vendim lidhur me kërkesën e paditësit

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së heshtjes administratave dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, nga shkresat e lëndës ka vlerësuar këto prova: Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë me titull “Furnizim me material për mirëmbajtje” me nr. të prokurimit 615-21-3917-1-1-1, e datës 21.06.2021, Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 11.10.2021, Ankesë e datës 01.11.2021 nga paditësi drejtuar OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material me mirëmbajtje” me nr. të prokurimit 615-21-3917-1-1-1, Raporti i ekspertit shqyrtues i datës 12.11.202, Kundërshtim i Ekspertizës i datës 19.11.2021 nga paditësi, Njoftim për dhënien e kontratës e datës 26.11.2021, Njoftim për nënshkrimin e Kontratës e datës 02.12.2021, Kontrata Publike Kornizë me nr. 615-21-3917-1-1-1/C617, e lidhur në mes të Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës dhe Operatorit Ekonomik “Liria” Sh.p.k, sa i përket aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me material

me mirëmbajtje”, me nr. t prokurimit 615-21-3917-1-1-1, Kërkesë për shqyrtimin e ankesës me nr. prot. 640/21 e datës 29.12.2021, drejtuar OSHP-së, Kërkesë për shtyrjen e implementimit të kontratës me nr. prot. 640/21 e datës 30.12.2021, drejtuar OSHP-së, Përgjigje nga OSHP-ja përmes emailit e datës 06.01.2022 drejtuar paditësit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me 35 të LKA-së, provave të administruara, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstatoi se paditësi më datë 01.11.2021 ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *“Furnizim me material për mirëmbajtje”*, me numër të prokurimit 615-21-3917-1-1-1. Më datë 29.12.2021, ka dorëzuar kërkesën për shqyrtimin e ankesës me nr. prot. 640/21, ndërsa i padituri deri në shqyrtimin e kësaj çështje nuk ka nxjerrë vendim përfundimtar lidhur me ankesën e paditësit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 13 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”* dhe nenit 29 par. 1 dhe 2 të LKA-së i cili përcakton se: *“1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa. 2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.”*

Gjykata i vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit për shkak të heshtjes administrative pasi që i padituri nuk ka vepruar brenda afateve ligjore për vendosje sipas ankesës së paditësit të dorëzuara pranë të paditurit.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë me titull *“Furnizim me material për mirëmbajtje”* me nr. të prokurimit 615-21-3917-1-1-1, e datës 21.06.2021, konstatohet se

autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës ka publikuar dosjen e tenderit 21.06.2021 me titull “*Furnizim me material për mirëmbajtje*”, me nr. të prokurimit 615-21-3917-1-1-1, hapja e tenderit për aplikim e parashikuar deri më datë 02.08.2012.

Nga Ankesë e datës 01.11.2021, paditësi ka parashtruar këtë ankesë, drejtuar OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “*Furnizim me material me mirëmbajtje*” me nr. të prokurimit 615-21-3917-1-1-1,

Paditësi më datë 29.12.2021 i është drejtuar OSHP-së, me kërkesë me nr. prot. 640/21 për shqyrtimin e ankesës së datës 01.11.2021 sa i përket aktivitetit të prokurimit me titull “*Furnizim me material me mirëmbajtje*”, me nr. të prot. 615-21-3917-1-1-1.

Paditësi më datë 30.12.2021 i është drejtuar OSHP-së me kërkesë me nr. prot. 640/21 për shtyrjen e implementimit të kontratës sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit publik me titull “*Furnizim me material me mirëmbajtje*”, me nr. të prot. 615-21-3917-1-1-1.

Nga Përgjigje nga OSHP-ja përmes emailit e datës 06.01.2022 drejtuar paditësit, OSHP ka njoftuar paditësin se në bazë të kompetencave që i ka lejuar Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja e Punës së OSHPA-së procedimi i ankesave po trajtohet deri në fazën e vendimmarrjes, por është e pa mundur që të merret ndonjë vendim sepse OSHP ende nuk ka Kryetarin dhe anëtarët e bordit, pra edhe në rastin e shqyrtimit të ankesave, OSHP nuk ka mundësi të merr asnjë vendim.

Neni 14 i Ligjit për Konflikt Administrativ përcakton se: “*Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.*”

Andaj, sipas nenit 124 par. 6 pika 6.1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se “6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përrjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror.” Sipas nenit 126 par. 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: “2. Çdo kërkesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, në qoftë se qëllimi i palës për të kundërshtuar një akt apo heshtjen administrative është mjaftueshëmërisht i qartë.” Ndërlidhur me këtë, neni 127 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme

Administrative i cili përcakton se: ;“4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.” Nga dispozitat e lartcekura, gjykata konstaton se paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën e datës 01.11.2021, ndërsa e paditura duke mos vendosur për ankesën e cekur më lartë, ka rënë në heshtje administrative në kundërshtim me afatet e përcaktuara lartë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në neni 46 par. 6 të LKA-së i cili përcakton se: “Kur padia është paraqitur në bazë të nenit 29 të këtij ligji, ndërsa gjykata konstaton se është e arsyeshme, do ta aprovojë padinë me aktgjykim dhe do të caktojë organin kompetent të nxjerrë vendimin”, andaj gjykata vendosi që të obligojë të paditurin Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, të vendos lidhur me ankesën e datës 01.11.2021, të paraqitur nga paditësi “Baki Ing” Sh.p.k, sa i përket Aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me material me mirëmbajtje” me nr. të prokurimit 615-21-3917-1-1-1 si dhe vendimin lidhur me këtë t’ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.1107/22, datë 04.11.2025

Gjyqtari

Gent Beker

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.